

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 10 MARS 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po debatojmë për një çështje, e cila prej kohësh është e qartë për të gjithë dhe ndodhet në pjesën e saj më të rëndësishme, atje ku duhet të ndodhet, përpara drejtësisë. Disa muaj me radhë në mënyrë të merituar komisioni bëri si duhet zhurmuesin, pasi dy alternativat që komisioni kishte ishin: ose të hetonte në mënyrë të thelluar, ose të merrte tavolinat dhe karriget e të qëndronte përpara SPAK-ut ditë dhe natë për t'i thënë të bënte punën e tij, pra të hetonte batërdinë, pasi faktet ishin aty. Është e tmerrshme të dëgjosh se si justifikohet dhe se si flitet për pastërtinë e Shqipërisë, për revolucionin mjedisor që ka ndodhur në Shqipëri, ku vit për vit kemi ditën e pastrimit të madh, kur pak muaj më parë Fieri u mbyt me renë toksike, kur verën që lamë pas mbeturinat mbytën vendin. Pra, ky është revolucionin që po ndodh.

Është e turpshme, por edhe fyese të flasësh për një Shqipëri shumë të pastër, kur faktet janë kaq të trasha, kaq evidente. Meqenëse u përmend Fieri, në 30 vjet nuk ishte parë një re toksike, por u pa për shkak të një menaxhimi mizerabël, pastaj flitet për një revolucion mjedisor. Për revolucionin mjedisor, meqenëse flisni shpesh, e dinë të gjithë se mënyra e trajtimit të mbetjeve kudo në Europë (nuk jemi një vend afrikan, kush do të ta kthejë Shqipërinë në një vend afrikan, ka mision të ndryshëm nga yni dhe ju e dini shumë mirë që piramida e mbetjeve nuk është kjo që kemi, kjo është me kokë poshtë) djegia është alternativa e fundit për të gjitha vendet europiane, meqenëse po flasim në emër të Europës dhe duam të integrohemi në Europë. Nuk besoj se del njeri dhe thotë që është e kundërta, nuk besoj të arrijë marrëzia deri këtu, sepse këto nuk i vendos opozita shqiptare, por kjo është strategjia, që ka pasur po e njëjta qeveri në këtë drejtim.

Megjithatë, problemi kryesor është pafajësia që duan t'i japin të gjithë procesit. Është e turpshme të flasësh për këtë dhe të bësh be për procedura të zhvilluara në mënyrë të shkëlqyer, kur një ish-ministër është në burg, një incenerator është i bllokuar dhe të gjithë ata, që po e zhvillonin këtë aferë të jashtëzakonshme, ndodhen në arrati. Pra, duhet të kesh kurajë idiote të vazhdosh të thuash që çdo gjë është bërë në rregull dhe në përputhje me ligjin. Nuk mund të shkojë çmenduria deri këtu, sepse ndryshe asnjë nga këto gjëra nuk do të ndodhnin. Të thuash që ka ndodhur revolucion i jashtëzakonshëm mjedisor se këta po punojnë dhe pastruan Shqipërinë, është përsëri një çmenduri, që i kalon kufijtë e arsyes. Unë e kuptoj që e kanë detyrë t'i bëjnë qejfin Edi Ramës, por jo në këtë mënyrë kaq të çmendur, sepse asnjë incenerator nuk është në punë.

Në një vend që prodhon plehra në dinamikë përditë, ata të dalin me qetësinë më të madhe dhe thonë që po bëhet revolucionin. Nuk punojnë inceneratorët, është fakt! Keni hall të na gënjeni ne dhe qytetarët? Po qytetarët e shikojnë që nuk punojnë. Kë gënjeni? Ky është rasti më i mirë për të thënë: kjo

është një aferë e tmerrshme, që e ka shpërdoruar dhe plaçkitur paranë publike, prandaj eja t'i shkojmë deri në fund kësaj afere. Ky ishte vendi i vetëm për të qenë konsensualë dhe mbikonsensualë, sepse nuk mbulohet, minarja nuk futet dot në xhep.

Megjithatë kalojmë te çështja konkrete. Përse them që komisioni bëri zhurmuesin? Sepse një nga problemet kryesore, ajo që dimë të gjithë, është të ndjekim paranë. Çfarë ka ndodhur me paratë? Si janë vjedhur? Tani mund të bëjnë be sa të duan dhe ta mbrojnë. Këto kompani përvetësuese, me emër dhe mbiemër, me numra, me NIPT-e e me të gjitha, janë kompani që kanë nga një njeri, ku një zonjë 85 vjeçe me një mbesë marrin 1 milionë euro, këto janë fakte, nuk janë të opozitës, janë në SPAK. Çfarë avokatie bëni? Tërhiqni diskutimet, mos vazhdoni më, kjo do përgjigje, është fakt. Nëse del njeri dhe rreh gjoksin dhe thotë se ka një kompani, që faturon sheqer dhe vaj për teknologji të inceneratorëve, atëherë këtu çmenduria ka ikur nga kontrolli. Është gjynah që njerëz, të cilët janë në këtë sallë, por nuk kanë lidhje me aferën, i bëjnë shërbim revolucionit të hajdutëve kot së koti. Ja ku i keni firmat dhe kompanitë e tjera për të tre inceneratorët.

Komisioni, çuditërisht, nuk thërret drejtuesit aktualë të tatimeve për të hetuar dreri në fund, meqenëse donte të bënte një hetim më të thelluar, sepse nuk solli asnjë, por afroi skenën për të bërë një estradë qeveritare, dhe të kërkonte librat e llogarive me radhë për të ndjekur paranë, sepse i kishin me emër e mbiemër të gjitha kompanitë që bënin batërdinë dhe qarkullonin ato para, shkarkonin TVSH me miliarda lekë, të cilat futeshin direkt në xhep. Pra, hetimi tatimor, që kontrollon këtë skemë, i cili është shumë i vëmendshëm t'i marrë edhe lekun e fundit dyqanit të vogël, këto miliarda nuk i kap. Çfarë tatimesh, çfarë hetimi tatimor kemi? Në emër të kujt flasim, që taksat dhe tatimet duhet të paguhen nga të gjithë, për kë? A e bëjnë detyrën? A u dëgjua në komision hetimor? A u thirrën të gjithë? Ministrja aktuale e Financave ka qenë drejtoreshë e Tatimeve. Janë disa raportet me qindra faqe të Kontrollit të Lartë të Shtetit, institucion i ngritur me Kushtetutë dhe me ligj, nuk u thërrit njëri.

Gjithë këto materiale, fakte, detyra të lëna, nuk i interesonin komisionit, që të hidhte dritë mbi miliardat? Pra, edhe këta ishin klientë të papërshtatshëm. Për sa na takon neve, si forcë politike, kemi bërë një punë të shkëlqyer, kemi denoncuar 3 kallëzime të mëdha, të cilat ndodhen të plotësuar edhe me kallëzime shtesë. Për këtë ne kemi bërë një denoncim konkret, me emra, mbiemra, me numra NIPTesh, me vende se ku hapeshin llogaritë, mënyrën se si paraja derdhej dhe qarkullonte në rrugë të pista, sigurisht prandaj prania jonë në këtë komision ishte e papranueshme, sepse do të ishte një prishje rehati. Shkuarja deri në fund e të vërtetave dhe ndjekja e parasë, do të nxirrte bela më të mëdha. Po të ndiqej me seriozitet kjo para, do të shikohej se po të njëjtat kompani, këto që i tregova me pamje, këto që kanë me nga 2-3 vetë, marrin investime në AZHBR, marrin tenderë në ujësjellës.

Pra, skema e depërtimit të parasë së pistë është fare qartë dhe e evidente, edhe këto janë denoncuar me emër dhe mbiemër. Në fund të ditës, nëse kjo detyrë nuk u krye, çfarë ndodhi me hetimin? Hetimi bëri të mundur që kjo estradë qeveritare të vazhdonte, por ajo që nuk lëviz është kjo: përgjegjësitë e Kryeministrit, i cili ka firmosur me dorën e tij; i gjithë aparati i Këshillit të Ministrave, në thyerje të çdo procedure, të çdo rregulli, ka miratuar një procedurë të paligjshme kryekëput, që nga sekretari i Përgjithshëm deri te Drejtoria Juridike e Këshillit të Ministrave e të tjera me radhë; kryetari i Bashkisë së Tiranës prej kohësh duhet të ishte përpara dritësisë, nëse drejtësia nuk duhet të ishte e kapur për fyti.

Shkelje të tilla kanë çuar prapa hekurave kush e di se sa njerëz, personalitete, ministra e me radhë. Për sa i takon batërdise në Fier, ata që e njohin, e dinë shumë mirë që një investim i madh u bë si top futbollli, përtej çdo studimi fizibiliteti lëvizte nga një vend te tjetri, paratë shtoheshin dhe vetë hiqeshin sikur ishin paratë e tyre. Me dy fjalë, meqenëse çdo gjë u bë në emër të emergjencës mjedisore, pra emergjencës që nuk priste, përgjigjja për këtë emergjencë mjedisore janë tre inceneratorët që nuk punojnë. Ku shkoi emergjenca? Emergjenca ishte shkaku për të vënë në lëvizje qindra milionë euro dhe atë rrahjen e gjoksit, që kemi vjedhur vetëm 100 milionë deri tani dhe nuk janë bërë akoma 430 milionë. Faleminderit!